

DEKLARATË

E PRIVATËSISË GJATË KRYERJES SË VIDEO-MBIKËQYRJES

Kjo Deklaratë e privatësisë e shpjegon llojin e të dhënave personale që Makedonski Telekom SHA – Shkup (në tekstin e mëtejshëm: Kontrolluesi ose MKT), i grumbullon prej jush me kryerjen e video-mbikëqyrjes gjatë vizitës në hapësirat zyrtare/afariste të saj dhe se si Kontrolluesi i shfrytëzon këto të dhëna.

1. Pse i mbledhim (përpunojmë) të dhënat personale?

(1) Kontrolluesi i mbledhë të dhënat përmes sistemit për video-mbikëqyrje për arsyet vijuese:

- Për shkak të kontrollit të qasjes në këto objekte zyrtare (ndërtesë, hyrje, hapësirë..) dhe hapësira afariste – sallone të shitjes, për të siguruar siguri në objekt, siguri për të punësuarit, vizitorët dhe shfrytëzuesit;
- Që të parandalohet dhe nëse është e nevojshme, të hetohet ndonjë qasje e paautorizuar fizike, duke përfshirë edhe qasjen e paautorizuar në hapësira të sigurta dhe të mbrojtura, infrastrukturën e TI, informacionet operative dhe pajisjet për qasje dhe ruajtjen e informacioneve, të cilat janë të locuara në hapësirat nën kontrollin e MKT;
- Të parandalohet, zbulohet dhe të analizohet ndonjë vjedhje, një akt tjetër i kundërligjshëm ose ndonjë veprim i dëmshëm i drejtuar ndaj pajisjeve apo mjeteve në pronësi të Kontrolluesit ose ndaj vizitorëve, të punësuarve ose shfrytëzuesve të cilët ndodhen në hapësirat zyrtare apo afariste të MKT;
- për parandalimin dhe kontrollin e kanosjeve të sigurisë së personelit i cili punon në hapësirat ose vizitorët në hapësirat e Kontrolluesit (për shembull: zjarr, sulm fizik etj.)

(2) Sistemi për video-mbikëqyrje nuk përdoret për qëllime të tjera, e as si mjet për ndjekjen e punës së të punësuarve ose pranisë së tyre.

(3) Kamerat për video-mbikëqyrje instalohen në pika qasëse në objekt (p.sh. hyrje/dalje, korridore, shkallë, hapësira para ashensorëve etj.) ose hapësira ku ruhet pajisja teknike dhe infrastruktura komunikuese. Sipas nevojës kamera instalohen edhe për mbikëqyrje në sipërfaqe të tjera rreth objekteve përmes së cilave qasen në pronë (p.sh. hapësirë parkimi, garazhe, qasje për shkarkimin e mallit hapësirë në depo etj.). Kontrolluesi i vendosë mjetet për video-mbikëqyrje, në mënyrë që të njëjtat nuk bëjnë incizim të hapësirës publike përreth, përveç hapësirës në afërsi të drejtpërdrejtë në hapësirat veta zyrtare dhe afariste.

(4) Kamerat kanë për qëllim të bëjnë shqyrtim të përgjithshëm të asaj që ndodhë në vendet të cilat janë nën video-mbikëqyrje, por të njëjtat parimisht nuk përdoren për njohjen e identitetit të personave fizikë përmes video-mbikëqyrjes. Megjithatë, në kushte kur në filmimet e video-mbikëqyrjes përcaktohet një vepër e kryer penale ose ngjarje tjetër e kundërligjshme ose e dëmshme në hapësirat e Kontrolluesit, të dhënat e video-mbikëqyrjes mund të përdoren për shkak të përcaktimit të identitetit dhe mënyrës së kryerjes së aktit të kundërligjshëm në kuadër të hetimit formal disiplinor ose penal ose të transmetuara tek organet shtetërore përkatëse në procedurën e paraparë me ligj.

2. Çfarë të dhënash mbledh Kontrolluesi?

Kontrolluesi mbledh vetëm pamje vizuale të cilat regjistrohen nga kamerat për video-mbikëqyrje. Kontrolluesi nuk kryen regjistrim zëri.

3. Kush është përgjegjës për përpunimin e të dhënave?

MKT si kontrollues e bën përpunimin e të dhënave personale dhe i përcakton qëllimet e këtij aktiviteti që është në përpunim e sipër. Qëllimet janë në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Specialisti i lartë për siguri korporative i Shërbimit për siguri korporative është person përgjegjës për video-mbikëqyrjen dhe është personi për kontakt.

4. Cila është baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit për video-mbikëqyrje?

(1) Kontrolluesi përdorë pajisje për video-mbikëqyrje për shkak të përmbushjes së qëllimeve vijuese të cilat janë në pajtim me nenin 90 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale:

- Mbrojtja e pronësisë
- Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve
- Kontrolli i hyrjes dhe daljes nga hapësirat zyrtare për qëllime sigurie

(2) Përveç kësaj në hyrje të çdo objekti zyrtar apo lokalitë afarist – sallone shitjeje, ka një njoftim të spikatur për video-monitorimin që u mundëson subjekteve të të dhënave personale të njihen me të dhënat bazë për video-mbikëqyrje, emrin e kontrolluesit që kryen video-mbikëqyrjen dhe mënyrën mbi të cilën mund të merret informacioni se ku dhe për sa kohë ruhen pamjet nga sistemi për video-mbikëqyrje.

5. Kush mund t'i shohë të dhënat e mia personale?

Vetëm personat e autorizuar për video-mbikëqyrje nga Kontrolluesi kanë qasje në video-regjistrimet, ndërsa personat e autorizuar nga agjencia e sigurimit të angazhuar kanë qasje edhe në filmimet drejtpërdrejt të video-mbikëqyrjes. Qasja në video-regjistruesit digjitalë dhe pajisjet teknike përkatëse në të cilat ruhen video-regjistrimet është e kufizuar, e mbrojtur nga aplikimi i masave teknike të sigurisë së të dhënave (fjalëkalimi dhe regjistrimi (log) për çdo ngjarje ose veprim nga punonjësit, gjegjësisht personat e autorizuar). Tek të dhënat, gjegjësisht video-regjistrimet, nuk mund të qaset pa autorizim nga MKT.

6. Si t'i realizoni të drejtat tuaja lidhur me të dhënat personale të video-mbikëqyrjes?

(1) Si subjekt i të dhënave personale keni të drejtë të kërkonti realizim të të drejtave të rregulluara me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale lidhur me të dhënat e juaja personale të cilat do të përpunoheshin me video-mbikëqyrje.

(2) Për realizimin e së drejtës tuaj, është e nevojshme të dorëzoni kërkesë në formë të shkruar, ku do t'i jepni emrin dhe mbiemrin tuaj, të dhënat për kontakt dhe do t'i shpjegoni rrethanat dhe të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me kërkesën tuaj. MKT ka të drejtë ta verifikojë identitetin tuaj dhe të kërkojë informacione shtesë për të vepruar mbi kërkesën.

(3) Kërkesën mund ta dorëzoni në arkivin kryesor të MKT që ndodhet në Shkup në Kej 13 Nëntori nr. 6 Shkup, me rekomandimin – për Oficerin për mbrojtjen e të dhënave personale ose në formë elektronike në adresën vijuese për postë elektronike – dpo@telekom.mk

7. A mund të qasem tek të dhënat e mia?

Ju keni të drejtë të kërkonti qasje në të dhënat tuaja në çdo kohë dhe falas, me dërgimin e kërkesës deri tek Kontrolluesi në pajtim me pikën 6 të dhënës më lartë.

8. A mund t'i ndryshoj të dhënat e mia?

Nuk lejohet ndryshimi i video-regjistrimit nga video-mbikëqyrja.

9. A mund të kërkoj kufizim të përpunimit të të dhënave të mia?

Ju keni të drejtë të kërkonti kufizimin e përpunimit të të dhënave tuaja personale duke i dërguar një kërkesë Kontrolluesit në përputhje me pikën 6 të dhënës më sipër, kur e kundërshtoni saktësinë e të dhënave tuaja personale, ose kur Kontrolluesit më nuk ka nevojë për të dhënat për të kryer detyrat e tij. Ju gjithashtu mund ta bllokoni përpunimin kur operacioni është i paligjshëm dhe ju e kundërshtoni fshirjen e të dhënave. Megjithatë, bllokimi nuk është i mundur në çdo rast të një hetimi zyrtar.

10. A mund t'i fshij të dhënat e mia?

Ju keni të drejtë të kërkonti fshirjen e të dhënave tuaja me dërgimin e kërkesës tek Kontrolluesi në pajtim me pikën 6 më lartë, nëse vlerësoni se përpunimi është i paligjshëm.

11. A ndahen të dhënat e mira personale me persona të tjerë?

Sipas rregullit, të dhënat e video-mbikëqyrjes ruhen nga Kontrolluesi dhe nuk ndahen me palët e treta, përveç nëse na kërkonti ose na jepni leje për t'i ndarë ato.

Në rast se ne ndajmë të dhënat tuaja me palët e treta, me kërkesën tuaj, ju do të njoftoheni se kujt i janë zbuluar të dhënat tuaja personale, për çfarë qëllimi dhe mbi çfarë baze ligjore.

12. A kam të drejtë ankimi?

Po, ju keni të drejtë të ankimimi dhe të kundërshtoni përpunimin në çdo kohë duke i dërguar një kërkesë Kontrolluesit në përputhje me pikën 6 të dhënë më lartë, kur keni arsye legjitime që lidhet me situatën tuaj të veçantë. Kontrolluesi do t'i përgjigjet kërkesës tuaj brenda 15 ditëve nga dita e shtrimit të kërkesës.

13. Çfarë mund të bëj në rast të ndonjë problemi?

a) Hapi i parë është ta njoftoni Kontrolluesin duke u paraqitur në numrine telefonit 02/32 42 908 në Shërbimin për siguri korporatave ku mund të merren informacione iniciuese për video-mbikëqyrjen dhe të kërkonti ndërmarrjen e aktivitetit përkatës.

b) Nëse nuk merrni përgjigje ose nëse nuk jeni të kënaqur me të, kontaktoni oficerin tonë për mbrojtjen e të dhënave personale në dpo@telekom.mk

c) Nëse vlerësoni se masat e ndërmarra nga Kontrolluese nuk janë të mjaftueshme, mund të shtroni kërkesë në Agjencinë për mbrojtjen e të dhënave personale www.azlp.mk

14. Kur do të fillojë përpunimi i të dhënave të mia personale përmes sistemit për video-mbikëqyrje?

Përpunimi fillon në momentin kur do t'i vizitoni hapësirat e Kontrolluesit.

15. Siguria e të dhënave personale

Kontrolluesi është i përkushtuar të mbrojë të dhënat tuaja personale. Kur kryeni video-mbikëqyrje, teknologjitë dhe procedurat e sigurisë aplikohen për të mbrojtur të dhënat tuaja personale nga një qasje e paautorizuar, përdorimi ose zbulimi i paautorizuar. Të dhënat tuaja ruhen në një sistem kompjuterik me qasje të kufizuar dhe në një mjedis të kontrolluar.

16. Sa i ruajmë të dhënat tuaja?

(1) Kontrolluesi sipas rregullit i ruan të dhënat tuaja personale nga video-mbikëqyrja për 30 ditë, pas së cilës të gjitha videot e regjistruara fshihen automatikisht.

(2) Si përjashtim, disa regjistrime të video-mbikëqyrjes mund të mbahen për një periudhë më të gjatë, nëse kërkohet nga një organ i autorizuar dhënë kontrolluesit në një procedurë të përcaktuar me ligj (p.sh. për kryerjen e një hetimi zyrtar ose zbulimin e autorit të një veprë penale), ose nëse regjistrimi nga video-mbikëqyrja është e nevojshme për kryerjen e procedurave të tjera në përputhje me ligjin ose interesin legjitim të Kontrolluesit, deri në përfundimin e procedurës.